



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.484/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga:** Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabanianëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2452/19 të datës 21.05.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 02.06.2021, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.517/2019 me numër protokolli 4108/2019 të datës 04.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi "Këndi i ri „Bill Klinton" në Komunë të Prishtinës , kundër organit të punësimit - Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datën 18.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.517/2019 e datës 04.09.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. ANULOHEN** Vendimi me numër protokolli 334 i datës 13.06.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës dhe Vendimi me numër protokolli 168 i datës 07.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA) i Administratën Tatimore të Kosovës.
- III. OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e marrjes së këtij vendimi, ankuesin ta sistemoj në njërin nga pozitat e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm, në Administratën Tatimore të Kosovës, pozitë për nga niveli të cilën ankuesi e ka mbajtur deri me datë 13.06.2019, si dhe që t'ia llogarisë pjesën e humbur të pagës, duke i bërë kompensimin e diferencës në pagë nga data 14.06.2019 deri në datën e zbatimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Arsyetim

Ankuesi i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës sipas Akt emërimit me numër 02/599/11 të datës 24.11.2016 në pozitën „Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm“, në Departamentin Funksionet e Veçanta, me datë 13.06.2019 Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 334 me të cilin ankuesin e ka caktuar në pozitën „Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Riskut“, me arsyetimin se kjo ka rrjedhur si rezultat i suprimimit të pozitës së punës Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm“, në Departamentin Funksionet e Veçanta, si dhe riorganizimin dhe nevojën e institucionit për funksionalizimin e Strukturës së re organizative e cila është aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i me datë 10.05.2019, si dhe për zbatimin e Rregullores ATK/nr.13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e datës 13.06.2019 me numër protokollit 334 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 08.07.2019 ka parashtruar ankesë me nr.11-06-2835 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Administratën Tatimore të Ankuesit .

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës me Vendimin me numër protokollit 168 të datës 07.08.2019 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokollit 168 të datës 07.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me 04.09.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 4108/2019 të regjistruar me numër A.nr.517/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 09.09.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datë 19.09.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 11.10.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 21.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2452/19, të pranuar me datë 02.06.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 14.10.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.2452/19 të datës 21.05.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 02.06.2021; Ankesë me numër protokoll 4108/2019 të datës 04.09.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 09.07.2019; Vendimi me nr.168 i datës 07.08.2019 Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës; Konkursi i brendshëm i datës 05.06.2021; Akt emërimi i datës 24.11.2016 nr, protokoll 07/599/11; Struktura e përgjithshme organizative e Administratës Tatimore, e datës 15.03.2016; Struktura e përgjithshme organizative e Administratës Tatimore e datës 10.05.2019; Vendimi nr. 153/2016 i datës 11.11.2016 KPMSHC-së; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018; Përgjigje në ankesë e datë 19.09.2019 nga Administrata Tatimore e Kosovës; Rregullorja nr.ATK-13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës e datës 17.05.2019; E-mail i datë 24.06.2016; E-mail i datë 16.05.2019; E-mail i datë 14.05.2019; Shkresë njoftuese lidhur me suprimimin e pozitive të punës si rezultat i riorganizimit të Administratës Tatimore e datës 14.05.2019; Ankesë Nr.protokoll 11-06-2501 e datës 12.06.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës, prej 1/18 faqe; Vendimi nr.334 i datës 13.06.2019 për transferim, nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së; E-mail i datë 13.06.2019; Vendimi me nr.145 i datës 11.07.2019 Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës (vendim sipas ankesës nr.protokoll 11-06-2501); Procesverbal mbi shqyrtimin e ankesës Nr.protokoll 11-06-2501 të datës 12.06.2019; Formulari mbi përshkrimin e detyrave të punës i datës 21.08.2012; Ankesë Nr.protokoll 11-06-2835 e datës 08.07.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës, prej 1//8 faqe; Procesverbal mbi shqyrtimin e ankesës Nr.protokoll 11-06-2835 të datës 08.07.2019; Prova shtesa nga ankuesi me datës 06.01.2021 , në formë elektronike [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net); Njoftim i datës 10.09.2019 nr. Protokoll 2781 nga DASHC/MAP; Mendimi juridik Nr.1031/2020 i Avokatit të Popullit i datë 09.07.2020; Itegriteti, Disipline dhe Etik në Administratën Tatimore të Kosovës; Njoftimi i KPMSHC-së i datës 11.10.2019;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Administrata Tatimore e Kosovës në këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.08/2012 për Nëpunësit Civil Tepricë, me Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë të Pavarura, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, gjate shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës sipas Akt emërimin me numër 02/599/11 të datës 24.11.2016 në pozitën „Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm” në Departamentin - Funksionet e Veçanta. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se me datën 13.06.2019 Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore duke u bazuar në nenin 28 dhe 32 të Ligjit



Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës,nenin 3 të ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat,i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-102 dhe Nr.04/L-223,nenin 4 të Rregullores Nr.08/2012 ka nxjerrë vendim me numër protokolli 334 për caktimin e z. nga pozita „Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm“, në pozitën „Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Riskut“, respektivisht është bërë transferim për të cilin ankuesi nuk e ka dhënë pëlqimin e tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër protokolli 334 i datës 13.06.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, për caktimin e ankuesit nga pozita „Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm“,në pozitën „Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Riskut“, është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 32 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën të Kosovës ku përcaktohet se:“1. Nëpunësit civilë, të cilët janë tepricë pas riorganizimit, suprimimit ose bashkimit të organizatës së tyre me një organizatë tjetër në kuadër të institucionit të cilit i takojnë, do të ricaktohen në administratën qendrore ose komunale, po qe se ekzistojnë pozita ekuivalente. 2. Në rast të mungesës së pozitave ekuivalente, nëpunësit civilë tepricë janë në përkujdesje të Qeverisë, gjegjësisht të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, e cila përkujdeset për ricaktimin dhe trajnimin e këtyre nëpunësve civilë. 3. Refuzimi për t’iu nënshtruar trajnimit rezulton me ndërprerje të periudhës së lëvizshmërisë dhe largim nga shërbimi civil. 4. Të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve civilë tepricë, duke përfshirë edhe pagat e tyre dhe trajnimin e tyre, përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa nëse nuk ka marrëdhënie tjetër pune. 5. Nëse brenda afatit prej një (1) viti nuk përcillet me ri-caktim në ndonjë post të shërbimit civil, shpie në përfundimin e statusit të nëpunësit civilë.” dhe dispozitat e nenit 4 të Rregullores Nr.08/2012 për Nëpunësit Civil Tepricë ku përcaktohet se “1. Në rastin e riorganizimit të një institucioni, njësia e personelit ka këto përgjegjësi: 1.1. të identifikojë nëpunësit civilë, pozitat e të cilëve janë suprimuar dhe t’i regjistrojë ata në regjistrin e nëpunësve civilë tepricë; 1.2. të njoftojë nëpunësit civilë tepricë për të drejtat dhe detyrimet e tyre, që dalin nga statusi i nëpunësit civil tepricë që përcaktohet me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (më tej: Ligji) dhe me këtë Rregullore; 1.3. të përpiqet të gjejë një pozitë ekuivalente të lirë për nëpunësin civil tepricë brenda institucionit. 2. Nëse institucioni nuk mund të ricaktojë nëpunësin civil tepricë në një pozitë ekuivalente brenda një muaji, nga data në të cilin nëpunësi civil është shpallur tepricë, përgjegjësia për menaxhimin e këtyre nëpunësve civilë i kalon ministrisë përgjegjëse për administratë publike,” dhe pretendimet e ankuesit janë të bazuara sepse në rastin konkret Administrata Tatimore e Kosovës gjegjësisht Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, ankuesin është dashur që ta sistemoj në një pozite ekuivalente në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës,konformë aktemrimit dhe dispozitave të nenit 32 të të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil, gjegjësisht ankuesi është dashur të trajtohet si nëpunës civile tepricë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.08/2012 dhe jo përmes formës jo ligjore si është transferuar në një pozitë tjetër më të ulët,përkundër që në hyrje të vendimit për ricaktim me numër protokolli 334 i datës 13.06.2019, është bazuar në nenin 32 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe nenin 4 të Rregullores Nr.08/2012,ku ligji dhe rregullorja në të cilat është bazuar vendimi parasheh ricaktim në pozita ekuivalente nëse ka brenda institucionit sipas aktemrimit të fundit,dhe nëse konstatohet se nuk ka pozita ekuivalente atëher duhet të veprohet konformë nenit 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil,prandaj pretendimi i ankuesit mbi këtë bazë është i bazuar.



Po ashtu pretendimet e ankuesit janë të bazuara lidhur me faktin se Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për të vlerësuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga palët, gjegjësisht ka shqyrtuar Organogramin e Administratës Tatimore të Kosovës, dhe pretendimet e ankuesit i cili në ankesën e parashtruar në Këshill ka deklaruar se , citoj: „Se nuk qëndron pohimi se nuk ka pozita të lira të Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm, pasi që institucioni ATK, me datë 05.06.2019 ka shpallur konkurs të brendshëm për rekrutimin e pozitave të punës, si në vijim:

1.Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm- Operacionet (1 pozitë),

2.Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm-Programme dhe Procedura (1 pozitë),

3. Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm-Mbështetje e Programeve dhe Procedurave (1 Pozitë), që të tri (3) pozitat kanë qenë të lira dhe të mbuluara me ushtrues të detyrave, të cilat janë shpallur në konkursin e datës 05.06.2019 dhe që janë ekuivalente me pozitën që ka ushtruar ankuesi sipas Akt emërimit të fundit me numër 02/599/11 të datës 24.11.2016, dhe nuk i është ofruar kjo mundësi ankuesit që të ricaktohet në një nga këto pozitat, prandaj kolegji duke analizuar këtë pretendim bazuar në shkresat e lëndës konstaton se nuk është i saktë deklarimi zyrtarë i ATK-së se nuk ka pasur pozita të lira me qëllim të sistemimit të ankuesit në një nga pozitat ekuivalente të cilën e ka mbajtur sipas aktemrimit të fundit,nga se gjatë kësaj periudhe nga ATK-ja është shpallë konkursë pikërishtë për poizta të këtij niveli dhe kjo vërtetohet nëse shikojmë shpalljen e konkursit të datës 05.06.2019 ,andaj pretendimi i ankuesit se gjatë periudhës së ricaktimit brenda institucionit ka pasur pozita të lira është tërësishtë i bazuar.

Po ashtu duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative , se si një akt administrativ si i tillë është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, nga momenti kur Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 334 të datës 13.06.2019 për caktimin e ankuesit nga pozita „Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm“, në pozitën „Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Riskut“, ku në pjesën hyrëse te tij vendimi theksohet se“... në qëllim që të njëjti të ruaj statusin e të punësuarit në ATK“, i cili ka vepruar në kundërshtim dhe me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës se Kosovës, që është përcaktuar se: “Nëpunësve civilë u garantohet mbrojtja kundër çfarëdo largimi të paarsyeshëm ose të panevojshëm nga vendi i tyre i punës ose ndryshimi i qëndrimit në detyrë”, si dhe transferimi është bërë në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës se Kosovës, ku përcaktohet se: “2. Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jo disiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë”, që në rastin konkret ankuesi nuk është transferuar që të ushtrojë funksionin e tij të njëjtë ose të ndryshëm,dhe që ta ketë të njëjtën kategori funksionale dhe gradë,andaj kolegji mbi bazë të analizimit të këtyre rrethanave konstaton se pretendimi sa i përket ricaktimit dhe aktit administrativë që lidhet me këtë pretendim është i bazuar,nga se me asnjë dispozitë ligjore nuk është i lejuar një veprim i tillë.

Bazuar në pretendimet e ankuesit sa i përket vendimit të ricaktimit kolegji duke analizuar me kujdesë bazën ligjore të nxjerrjes së këtij vendimi si dhe arsyetimin,konstaton se me rastin e nxjerrjes së Rregullores së datës 17.05.2019 nga ATK-ja, është vërtetuar nga shkresa zyrtare e datës 10.09.2019 me numër protokolli 2781 e Ministrisë përgjegjëse, gjegjësisht Ministrisë së Administratës Publike, e cila ka konstatuar se nuk janë respektuar dispozitat e ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura nga



Administrata Tatimore e Kosovës, me rastin nxjerrjes së Rregullores nr.ATK-13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, të datës 17.05.2019, sepse nuk ju ka nënshtruar procedurave ligjore siç e përcakton Ligji Nr.06/113 , për aprovimin e kësaj rregullore, si dhe Ministria përkatëse e Administratës Publike konstaton pamundësinë e aprovimit të pozitive të lira si rezultat i dilemave që ekzistojnë në organizimin e brendshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, andaj nga kjo shkresë zyrtare nga një organë kompetentë mund të nxjerret përfundimi se Administrata Tatimore e Kosovës, me as një provë nuk ka dëshmuar se ka miratim nga Kryeministri dhe nga ministria përgjegjëse në pajtim me nenin 28 paragrafi 3 ku përcaktohet se : **3. Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat**”, si dhe paragrafi 6 i Ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ku përcakton se: **“6. Qeveria e Kosovës, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton Rregulloren për standardet të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, procedurat e detajuara për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm, si dhe përmbajtjen e memorandumit shpjegues të propozimit”**, andaj nga ajo që u tha më lartë dhe që u vërtetua përmes shkresave të lëndës, nga kolegji u konstatua se nuk ka pasur aprovim konformë nenit 28, paragrafi 3 dhe 6 të Ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura me rastin e nxjerrjes së Rregullores Nr.ATK-13/2019 të datës 17.05.2019, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe mbi këtë bazë pretendimet e ankuesit janë të bazuara, sepse vendimi me numër protokollit 334 i datës 13.06.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës mbi ricaktimin është i pabazuar dhe se është mbështetë në një dokumentë që nuk prodhon efektë juridik përderisa nuk nxjerret konformë dispozitave përkatëse ligjore.

Prandaj kolegji konstaton se përderisa një strukturë organizative e një agjencioni nuk është nxjerrë konformë dispozitave ligjore në fuqi, qdo lëvizje në këtë drejtim mbi bazë të një rregullore të tillë nuk mund të prodhojë ndonjë efektë juridik, dhe se qdo lëvizje e stafit do të duhet të bëhet mbi bazë të procedurave ligjore dhe duke u bazuar në strukturë organizative që është ka qenë me fuqi ligjore më herët se kjo që është kontestuese sipas ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore i Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 168 të datës 07.08.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, nga se me rastin e shqyrtimit të ankesës nuk ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil me rastin e vendosjes meritore, pasi nuk ka marrë për bazë pretendimet e ankuesit, dhe se vendimin e ka bazuar në një ristrukturim mbi një rregullore që nuk ishte nxjerrë sipas dispozitave ligjore. Poashtu ky vendim është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, poashtu vendimi i komisionit është në kundërshtim edhe me legjislacionin në fuqi që rregullon qështjen e protokollimit të një akti administrativë, nëse shikojmë përmbajtjen shihet se vendimi nga komisioni është marrë më datë 16/07/2019 ,ndërsa është protokoluar më datë 07/08/2019, që është në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyre dhe nenin 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të udhëzimit administrativë 01/2017 për



administrimin e punës në zyre, andaj edhe mbi këtë bazë vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës me numër protokollit 168 i datës 07.08.2019, ka të meta përmbajtësore në aspektë ligjorë, me që rastë e bënë të bazuar pretendimin sa i përket bazës ligjore me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi të kontestuar nga ankuesi.

Andaj bazuar në provat e lëndës është konstatuar edhe fakti se ankuesi me datë 19.06.2019 ka parashtruar ankesë tek Avokati i Popullit, kundër veprimeve të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, lidhur me nxjerrjen e Rregullores nr. ATK-13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, të datës 17.05.2019, dhe nxjerrjen e Vendimit me numër protokollit 334 të datës 13.06.2019 për caktimin e ankuesit nga pozita „Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm”, në pozitën „Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Riskut”, i cili ka rënë ndesh me Ligjin Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi të cilën e dëshmon dhe Mendimi juridik Nr.1031/2020 i Avokatit të Popullit i datë 09.07.2020, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus curiae), i cili ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës ka hartuar strukturën organizative duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore të Kosovës, për të cilën çështje Avokati i Popullit ka kërkuar informatë zyrtare nga përfaqësuesi i ATK-së lidhur me diskriminimin që është bërë ndaj ankuesit, dhe përgjigja e ATK-së me datë 24.09.2019 përmes postës elektronike nuk ka përmbajtur asnjë argument të arsyeshëm apo qëllim legjitim që ankuesit që nuk janë diskriminuar mbi bazat e ngritura në ankesë, dhe në rastin konkret Avokati i Popullit ka konstatuar se duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, ka kompetencë të emërojë persona sipas nevojës për të zbatuar dispozitat e ligjit në fuqi për ATK-në, po ato çdoherë duhet të jenë në përputhje me rregullat e Shërbimit Civil të Kosovës”, ndërsa në rastin konkret veprimet administrative të ATK-së kanë qenë të kundërligjshme në raport me ankuesin, dhe kjo rrethanë është konfirmuar edhe nga mendimi juridik i avokatit të popullit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e lëndës ka konstatuar se pretendimet e ankuesit janë të bazuara, të cilat janë vërtetuar edhe nga Avokati i Popullit dhe që janë të sqaruara në mënyrë të hollësishme më lartë, andaj obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që në afat ligjor si në pikën III të këtij vendimi ta sistemojë ankuesin në një nga pozitat ekuivalente të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm, në Administratën Tatimore të Kosovës, pozitë për nga niveli të cilën ankuesi e ka mbajtur deri me datë 13.06.2019, si dhe që t’ia llogarisë pjesën e humbur të pagës, duke i bërë kompensimin e diferencës në pagë nga data 14.06.2019 deri në datën e zbatimit të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hy në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.484/2021, datë 18.06.2021

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

